

# ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË SË DEPARTAMENTIT TË METODOLOGJISË, PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL, PËR VITIN 2024



12 Shkurt 2025

**Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional zhvilloi analizën vjetore të tij, në kuadër të aktiviteteve që Kontrolli i Lartë i Shtetit po kryen për të paraqitur punën e vitit 2024.**

Në këtë aktivitet, fjalën hyrëse e mbajti Kryetari i KLSH - së, Z. Arben Shehu, i cili vlerësoi angazhimin serioz dhe punën e përkushtuar të departamentit në mbështetje të punës së auditimit në KLSH. Aktiviteti vijoi me fjalën e Drejtores së këtij Departamenti, znj. Aulona Jonuzi, e cila përcolli në mënyrë koncize punën, arritjet dhe sfidat e vitit të mëparshëm.

Më konkretisht, përgjatë vitit 2024, Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional është angazhuar në monitorimin e vazhdueshëm të procesit të planifikimit vjetor të auditimeve dhe konsolidimit të të dhënave, përfshirë këtu edhe monitorimin periodik mujor të zbatimit të tij. Ky departament ka qenë i angazhuar në projektin Pilot për zbatimin në KLSH të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë sipas ISSAI 140 (i rishikuar) me mbështetjen e IDI - t (Iniciativës për zhvillim të INTOSAI - t). Në veçanti ky projekt ka mundësuar miratimin e dokumenteve kyç për zbatimin e ISSAI 140 (të rishikuar), Politikën e Menaxhimit të Cilësisë në KLSH, Udhëzuesin mbi Menaxhimin e Risqeve të Cilësisë, Udhëzuesin mbi Procesin e Monitorimit dhe Përmirësimit të Cilësisë.

Veprimtaria e departamentit është fokusuar edhe në drejtim të menaxhimit të procesit të trajnimeve në KLSH në të gjitha fazat e tij, duke realizuar objektivin prej 20 - 25 dite trajnimi për çdo auditues.

Monitorimi i Planit Strategjik 2023 - 2027 të KLSH - së, sipas Planit të Veprimit, hartimi i raportit përkatës të monitorimit dhe dërgimi i tij në Kuvend ka qenë një tjetër aktivitet me rëndësi, i cili është mbuluar me përgjegjshmëri nga ky departament.

Në kuadër të përmirësimit të raportimeve që KLSH bën në Kuvend, Departamenti i Metodologjisë ka koordinuar punën me departamentet e auditimit për hartimin e Raportit të Aktivitetit të KLSH - së; ka vijuar të hartojë buletin Statistikor të KLSH - së në format reader friendly; ka plotësuar databazën mbi zbatimin e rekomandimeve dhe populluar me të dhëna Platformën Ndërinstitucionale të Kuvendit me të dhëna mbi zbatimin e rekomandimeve, etj.

Gjatë vitit 2024, Departamenti u përball me përgjegjësi të konsiderueshme dhe me numër stafi të kufizuar, por pavarësisht kësaj, fokusi i ekipit në projektet me prioritet të lartë mundësoi që edhe për vitin 2024, kjo strukturë të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga objektivat strategjike të KLSH - së, rezoluta e Kuvendit si dhe Rregullorja e Brendshme e institucionit.

